




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Prop. No. Prop. No. 2-D/DPK Nr. i foli Nr. i foli 02 Nr. pages Nr. pages	Nr. Prot. Nr. Prot. 01-4934/15 Prot. No. Prot. No. Data Data 29.12.2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-4176/15, për z. Muhamet Behra – Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për z. Muhamet Behra – Drejtor i Drejtorisë për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Behra është hetuar për konflikt interesi për shkak se krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë, ka qenë pronar i vetëm në biznesin privat N.T.P. “Blerina”.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht zyrtarit i ka dërguar shkresën njoftuese për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e Agjencisë.

z. Behra është njoftuar për kufizimet në ushtrimin e funksioneve tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka mbyllur biznesin privat "Blerina". Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

